



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.109/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me zyrtaren ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së flamujve në shtyllë të ndriçimit publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dhe koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Mitrovicë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 4,500.00 (katërmijepesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 06.06.2017, nga Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkëngjitur si dëshmi fotografinë e printuar nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 06.06.2017, rreth orës 15.45, në sheshin “Mehë Ukaj” në Mitrovicë, monitoruesi i tyre ka hasur në flamuj të vendosur në shtyllë të ndriçimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni PDK-AAK-NISMA. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1, pika b, e Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe konsideron se Koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur flamuj në shtylla të ndriçimit publik. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkëngjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë koalicioni PDK-AAK-NISMA, të datës 07.06.2017, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivistë të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore, dhe se pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur një foto nga vendi ku janë larguar flamujt.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se flamujt e vendosur nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, janë vendosur në shtylla të ndriçimit publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që flamujt nga ky koalicion, janë vendosur në shtylla të ndriçimit publik të qytetit. Të njëjtën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni PDK-AAK-NISMA, në përgjigjen në ankesë të datës 07.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja nga ana e këtij koalicioni është përsëritur shumë herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti flamujt nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, janë vendosur në shtylla të ndriçimit publik. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që koalicionit, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i kanë tërhequr flamujt në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 109/2017 më datën 07.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri

The image shows a circular official stamp of the Panel for Complaints and Appeals (PZAP) in Pristina. The stamp contains the text 'Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa', 'PZAP', 'Prishtinë / Pristina', and 'Zyra e Kryesuesit'. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.